



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:249552

Datë: 07.11.2024

Numri i dokumentit: 06641019

C.nr.1130/2016

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke shqyrtuar dhe zgjidhur kontestin nga marrëdhënia juridike të paditësit Rr. P., nga H., i përfaqësuar nga Kompania e Avokatëve “A.” me seli në Prishtinë, të paditurës Gazeta “E.” me seli në Prishtinë, rr. “P. J.” nr..., e përfaqësuar nga A. K., Avokat dhe G. V., Avokat, rr. F. A. ..., me objekt të kontestit vërtetimin e shpifjes dhe fyerjes dhe kompensimin e dëmit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur më 07.11.2024, në seancë publike, në të cilën kanë prezantuar paditësi, i autorizuari i tij dhe e autorizuar e të paditurës, të njëjtën datë dha këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit Rr. P., nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurës Gazeta “E.” me seli në Prishtinë, ka shpifur dhe fyer në dëm të paditësit sepse të njëjtit i është përdorur foto-ja si imazh në emisionin e titulluar “Z. E.” përkatësisht e titulluar “Vjedhje në kohë lufte“, ku në minutën e 42-të të emisionit i cili është transmetuar në televizionin publik dhe është ri-edituar në shumë media të shkruara elektronike dhe është përdorur fotoja e paditësit në kundërshtim të plotë me ngjarjen dhe tekstin e këtij emisioni, dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jomaterial t’ia paguaj shumën prej 150,000.00€, me kamatë ligjore.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë ka parashtruar padi me datë: 29.10.2019, kundër të paditurës Gazeta “E.” , me objekt të kontestit dhe vlerë të objektit të kontestit si në hyrje të këtij aktgjykimi, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se e paditura ka shpifur dhe fyer në dëm të paditësit ku të njëjtit i është përdorur foto-ja si imazh në emisionin e titulluar “Z. E.” përkatësisht e titulluar “ Vjedhje në kohë lufte“ emision ky prodhim i Gazeta “E.” me autor L. K., ku në minutën e 42-të të emisionit i cili është transmetuar në televizionin publik dhe është ri-edituar në shumë media të shkruara elektronike dhe është përdorur fotoja e paditësit në kundërshtim të plotë me ngjarjen dhe tekstin e këtij emisioni, duke marrë për bazë që i tërë emisioni është në kontekst negativ dhe krijon dyshime për keqpërdorimet e mundshme ku si rezultat, paditësit i është shkaktuar dëm tejet i madh moral dhe material. Si rezultat I këtij emisioni, paditësi ka pasur qindra shqetësime nga qytetarë të ndryshëm duke i kërkuar që të din se a ka qenë i përfshirë në grumbullimin, menaxhimin apo edhe keqpërdorimin e mundshëm të shumave të mëdha të mjeteve financiare të dedikuara për financimin e luftës çlirimtare. Si rezultat I këtij emisioni paditësi ka pasur ngarkesa emocionale dhe ka pësuar nivel të lartë të dëmtimit të imazhit dhe kredibilitetit në jetën publike dhe biznesore, nuk është kontestues fakti që paditësit i është cenuar rëndë personaliteti. I njëjti nëpërmjet kësaj padie i ka kërkuar gjykatës që të nxjerr aktgjykim me të cilin do të miratohet kërkesëpafia e paditësit Rr. P. dhe të detyrohet Media Works, Gazeta “G. E.” Adresa: Rr.P. J., Nr..., 10000 Prishtinë, Kosovë, gjithashtu që të detyrohet t’ a heq nga emisioni foton e paditësit z. Rr. P. në emisionin “Vjedhje lufte” dhe t’ia paguaj shumën e të hollave dhe atë për dëmin moral 150.000€ dhe për dëmin material 150.000€. I njëjti ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës sipas tarifave ekzistuese të gjithë këtë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën ekzekutimin e me dhunë duke e llogaritur edhe kamatën ligjore nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

I autorizuari i paditësit, në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj si të bazuar. Në fazën e seancës përgaditore i njëjti e ka bërë edhe ndryshimin e kërkesëpadies ashtu që paditësi heq dorë nga kërkesa e tij për dëmin material dhe tani e tutje kërkesa e paditësit ndaj të paditurës është kërkesa për dëmin jo-material që konsiston me dhimbjet shpirtëror, ankthin e përjetuar, dëmtimin e reputacionit për shkak të keqpërdorimit të

fotos në emisionin e të paditurës të titulluar “vjedhje në kohë lufte” ku në minutën e 42-të të këtij emisioni është shfaqur fotoja e paditësit në kontekst negativ. Ndërsa në fjalën përfundimtare i njëjti ka deklaruar se me provat e administruara vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë, në bazë të video inçizimit dhe fotos, të administruara në këtë çështje, vërtetohet se e paditura e ka përdorur foton e paditësit në kontekst negativ. I njëjti ka theksuar se në këtë emision nuk ka qenë temë paditësi, por që është keqpërdorur fotoja në kontekstin negativ dhe nga ai emision dhe nga foto, paditësi ka pranuar mesazhe negative në të gjitha portalet ku është shfaqur ky artikull e në të cilat, paditësi ka përjetuar dhimbje shpirtërore, frikë, ankth, dëmtim të imazhit dhe të reputacionit të tij, për shkak se i njëjti është fytyrë publike dhe kjo foto e ka dëmtuar figurën e tij për shkak se është përdorur në kontekstin negativ. I autorizuari I paditësit në fjalën përfundimtare përveç të tjerash I ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes së lartësisë së kërkesëpadisë, të ketë parasysh praktikat gjyqësore në lidhje me rastet e ngjashme dhe të vendos konform kritereve të udhëzuesit të Gjykatës Supreme, për kategoritë e dëmit jo-material.

I njëjti i ka kërkuar shpenzimet procedural dhe atë për padinë shumën prej 325.000 euro dhe shpenzimet e dy seancave në shumën prej 845.000 euro si dhe taksën gjyqësore 500 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore.

I autorizuari i të paditurës me anë të përgjigjes në padi dhe në seancat e mbajtura si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë duke vlerësuar se çështja në fjalë nuk hyn në fushë veprimtarin e ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes. Tutje thekson se shfaqja e një fotografie të cilën pretendon paditësi në emisionin e theksuar, nuk mund të konsiderohet asses si deklaratë e cila ka theksuar ndonjë të pavërtetë për paditësin e që do të mund të konsiderohet shpifje apo diçka tjetër në lidhje me karakterin nënçmues e që do të mund të konsiderohet fyerje. Sipas të autorizuarit të të paditurës çështja nuk ka të bëjë me të mirat që mbrohen nga Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Tutje i autorizuari i të paditurës ka theksuar se paditësi nuk ka ndërmarr veprime paraprake para se t’i drejtohet gjykatës, sepse e paditura është prodhues medial dhe në rastin konkret vlejnjë rregulla të veçanta konform ligjit sa i përket veprimeve paraprake që duhet të i ndërmarrë paditësi dhe kjo kërkesëpadi sipas të autorizuarit të të paditurës duhet të refuzohet si e pabazuar. I njëjti ka

theksuar se mbesin në tërësi pranë pretendimeve të parashtruara në përgjigjet në padi dhe të gjitha argumenteve të parashtruara deri në këtë fazë gjyqësore.

Me anë të përgjigjes në padi e paditura e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, pasi që e njëjta është tërësisht e paqartë dhe e paartikulluar kjo për faktin se paditësi në padi nuk ka pretenduar se ai është i ndërlidhur me kontekstin e emisionit kontestues i cili ka trajtuar ndër të tjera, grumbullimin, menaxhimin dhe keqpërdorimin e pretenduar të shumave të mëdha të mjeteve financiare të dedikuara për financimin e luftës çlirimtare. Ndër të tjera ka theksuar se paditësi pretendon se me shfaqjen e forografisë së tij brenda kontekstit negativ të emisionit kontestues, paditësit i është shkaktuar dëm i madh material dhe jo-material, si rezultat i cenimit të personalitetit dhe dëmtimit të imazhit dhe kredibilitetit në jetën publike dhe biznese, për çka ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo-material në vlerë të përgjithëshme prej 300,000.00 euro. Përmes përgjigjes në padi e paditura ka theksuar se kjo padi është e parregullt në kuptimin formal ngaqë paditësi ka dështuar të mbështes pretendimet e tij në bazën relevante ligjore, duke përcaktuar qartë të drejtën që i takon dhe se kjo e drejtë i është shkelur nga e paditura. Sipas të paditurës këto shkelje përmbajnë elemente esenciale të ndryshme e të cilat duhet të saktësohen qartë në padi, në mënyrë që gjykata të vlerësojë pretendimet e parashtruara të paditësit. Sipas përgjigjes në padi të të paditurës, nuk është e qartë nëse paditësi pretendon se publikimi i fotografisë së tij në kontekstin negativ të emisionit kontestues jep një përshtypje specifike tek shikuesit, e cila përshtypje ka një kuptim të definuar, që sipas tij është shpifës, ose se është fyes ose se publikimi i fotografisë së tij pa lejen e tij përbën cenim të së drejtës së tij në privatësi. Tutje, e paditura ka theksuar se paditësi ka dështuar të precizojë mënyrën dhe metodologjinë e ndjekur për të përcaktuar llojin, lartësinë dhe vëllimin e dëmit material dhe jo-material, që pretendon se e ka pësuar si rezultat i veprimit të të paditurës. Gjithashtu, paditësi në padi sipas të paditurës nuk ka arritur të saktësojë lidhjen kauzale ndërmjetë dëmit që pretendon se e ka pësuar dhe përmbajtjes së shkrimit kontestues, në pajtim me dispozitat e LMD-së.

E paditura përmes përgjigjes në padi ka kërkuar nga gjykata që me anë të aktvendimit me të cilin e hedh poshtë padinë si të palejuar, në kuptim të nenit 391, paragrafi f) i Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Tutje ka deklaruar se paditësi nuk i ka shterur mjetet juridike para parashtrimit të padisë sepse meqenëse paditësi pretendon se publikimi i fotografisë së tij në njërin pjesë të emisionit kontestues ka qenë shqetësues për të, ai është dashur të shfrytëzoj “të drejtën për t’u përgjigjur apo të drejtën për reagim“, sipas nenit 13 të Ligjit Kundër Shpifjes dhe Fyerjes. I njëjti ka pasur mundësin e parashtrimit të kërkesës për modifikimin e emisionit kontestues pranë organit kompetent rregullativ-Komisionit të Pavarur për Media, në pajtim me përmbajtjen e nenit 12 të LKShF-së. Pra, sipas të paditurës paditësi është dashur të ndërmerri veprime paraprake, para se të deponojë këtë padi për kompensimin e dëmit material dhe jo-material.

Tutje ka theksuar se padia është e pabazuar në kuptimin material kjo për faktin se paditësi nuk është fare subjekt për të cilin bëhet fjalë në emision dhe se në asnjë pjesë të emisionit kontestues nuk përmendet emri dhe mbiemri i paditësit. Fotografia e paditësit teksa pin kafe me z. G. Th. e i cili është njëri prej protagonistëve kryesorë të emisionit, sipas palës së paditur është një fotografi e rëndomtë e cila fare nuk ndërlidhet me kontekstin e emisionit, rrjedhimisht paditësi nuk mund të pretendojë se i është shkelur ndonjë e drejtë , ku si rezultat i kësaj shkeljeje ka pësuar dëm material dhe jo-material në vlerën e cekur në padi.

Tutje ka theksuar se paditësi nuk e ka saktësuar llojin, lartësinë dhe vëllimin e dëmit të pretenduar. Pra, sipas të paditurës nuk është e qartë mënyra dhe metodologjia e ndjekur për të përcaktuar llojin, lartësinë dhe vëllimin e dëmit që pretendohet se është shkaktuar ndaj paditësit dhe se si dëmshpërblimi, që sipas paditësit arrin shumën e përgjithshme prej 300,000.00 euro, përbën shpërblimin e plotë të dëmit të pretenduar, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gjithashtu paditësi nuk ka arritur të ofroj dëshmi se si ka ndikuar publikimi i fotografisë në emisionin kontestues psh në uljen e të hyrave të veprimtarisë ndërmarrëse të cilën e udhëheqë, pra nuk është e qartë se nga padia është tërësisht e paqartë se për çfarë dëmi material bëhet fjalë. E paditura pretendon se paditësi ka dështuar të provojë dëmin jomaterial/moral që pretendon se e ka pësuar, për shkak se i njëjti është dashur të saktësojë se si dhe në çfarë vëllimi është pësuar dëmi jomaterial/moral nga ai, duke përshkruar specifikisht ankthin dhe dhimbjen shpirtërore që mund të ketë pësuar, nëse u është drejtuar institucioneve shëndetësore për ankthin dhe dhimbjen e pretenduar, si dhe për vëllimin e dëmit ndaj reputacionit të tij dhe se ky dëm i pretenduar mund të ketë ndikuar në jetën e tij private dhe publike.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi në shumën prej:325 euro dhe për shpenzimet e dy seancave në total shumën prej 845 euro.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova: - Video incizimi , - Foto e marrur nga emisioni i “ Vjedhje në kohë lufte“.

Pasi që gjykata beri vlerësimin e secilës prove veç e veç, e ne lidhmëni me njëra tjetrën, çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegjes, e duke u mbështetur ne dispozitat e nenit 8 te LPK-së, erdhi ne përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë dhe ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, pasi që vërtetoi këtë gjendje faktike.

Në këtë çështje juridike nuk ishte kontestues fakti se e paditura në emisionin “Z. E.“ përkatësisht në emisionin e titulluar ”Vjedhje në kohë lufte” kishte përdorur foton e paditësit, emision ky prodhim i “G. E.”.

Kontestuese në këtë çështje ishte baza juridike e kërkesëpadiës, respektivisht nëse fotografia e përdorur në fjalë kishte përmbajtje shpifëse dhe fyese ndaj paditësit – gjë që do të ishte bazë për kompensimin e dëmit.

Për vërtetimin e fakteve kontestuese gjykata iu ka referuar provave materiale, respektivisht artikullit kontestues të publikuar nga gazeta “G. E.”.

Kjo gjykatë vlerëson se, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, bazuar në provat e administruara, dhe mbi gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, kërkesëpadia e paditësit sa i përket vërtetimit të shpifjes dhe fyerjes është e pathemeltë në prova dhe ligj, për arsye se:

Me nenin 1 paragraf 1, pika a) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji nr. 02/L-65), përcaktohet se: “ Ky Ligj ka për qëllim të rregulloj përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje duke siguruar: a) Të drejtën e lirisë së shprehjes siç garantohet me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9

të dt. 15 Maj 2001) dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore në Njeriut, ndërsa në pikën b), të po këtij neni, përcaktohet se: “ Rregullat që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen të mos vënë kufij të paarsyeshëm mbi lirinë e shprehjes duke përfshirë edhe publikimin dhe diskutimin e çështjeve me interes të rëndësishëm për publikun”.

Me nenin 3, pika a) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklaratë të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër ”, në pikën b), përcaktohet se: “Fyerja nënkupton deklarin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese ”, në pikën j), përcaktohet se: “ Zyrtar publik nënkupton çdo person i cili ushtron autorizime publike për një autoritet publik ”, ndërsa në pikën k), të po këtij neni, përcaktohet se: “ Çështje e interesit publik nënkupton çdo çështje e cila është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë dhe mos u kufizuar në çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha degët e pushtetit, politikë, shëndetësi dhe siguri publike, zbatim të ligjit, administrim të drejtësisë, interes të konsumatorëve dhe interes shoqëror, ambient, çështje ekonomike, ushtrim të pushtetit, shkencë, art dhe kulturë ”.

Me nenin 5 paragraf 1 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë ligj”, ndërsa me paragrafin 4, të po këtij neni, përcaktohet se: “Autoritetet publike ndalohen nga paraqitja e kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja. Zyrtarët publik mund të paraqesin kërkesë për kompensimin e dëmit nga shpifja ose fyerja, privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal ”.

Me nenin 7 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mirë, duke marr parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla ”.

Me nenin 9 paragraf 1 pika c) të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Deklaratat e dhëna nuk bartin përgjegjësi në bazë të këtij ligji, nëse i padituri dëshmon se ato janë bërë në cilën do nga rrethanat në vijim: a) çdo deklaratë e bërë gjatë çdo faze të procedurave paragjyqësore, gjyqësore ose administrative, nga cilido që është përfshirë direkt në këtë procedurë, përveç rasteve kur provohet se deklarata në fjalë nuk lidhet fare me procesin gjyqësor;, ndërsa në pikën h), të po këtij neni, përcaktohet se: “ një raportim i drejtë dhe i saktë nga çdo material që përmbahet në paragrafët (a) - (g) të këtij neni;”, kurse në pikën i) të këtij neni përcaktohet se një raportim i drejtë dhe i saktë i çdo materiali që përbën një dokument zyrtar, ku statusi i këtij dokumenti arsyeton përhapjen e materialit, siç janë dokumentet zyrtarë të dala nga një hetim publik, ose nga një gjykatë ose legjislacion i huaj;.

Me Neni 12 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: Para parashtrimit të një padie sipas këtij Ligji, një person që pretendohet të jetë i dëmtuar do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të zbutur çdo dëm të shkaktuar nga shprehja. Në veçanti, paditësi do të kërkojë përmirësimin e asaj shprehje nga personi i cili pretendohet të ketë shkaktuar dëmin. Veprimet e tilla mund të përfshijnë kërkesën e përmirësimit të shprehjes së supozuar shpifëse apo fyese nga publikuesi dhe paraqitjen e kërkesës para organit kompetent rregullativ sikurse (Komisioni i Pavarur për Media) ose Organi vetë rregullativ sikurse (Këshilli për Mediat e Shtypura).

Me Neni 13 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një gazetë, botim periodik, transmetim radioje ose televizioni, ose në çdo media tjetër të një natyre periodike, për të cilin ose për cilat fakte janë bërë të disponueshme për publikun të cilat ai i deklaron që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që shqetësojnë atë person.

Me kërkesën e parashtruesit, media në fjalë është e detyruar të publikojë përgjigjen që parashtruesi i ka dërguar asaj.

Si përjashtim, publikimi i përgjigjes mund të refuzohet ose redaktohet nga media në rastet që vijojnë:

a) nëse kërkesa për publikimin e përgjigjes nuk i dërgohet medias brenda shtatë (7) ditësh nga dita kur ka kuptuar për publikimin;

- b) nëse gjatësia e përgjigjes e tejkalon atë që është e nevojshme për të korrigjuar informacionin që përmbante faktet që pretendohet të jenë të pasakta;
- c) nëse përgjigja nuk kufizohet në korrigjimin e fakteve të vëna në dyshim;
- d) nëse ajo përbën një ofendim të dënueshëm;
- e) nëse ajo konsiderohet në kundërshtim me interesat e mbrojtura me ligj të një pale të tretë;
- f) nëse individi i prekur nuk mund të provojë ekzistencën e një interesi të ligjshëm. Publikimi i përgjigjes duhet të bëhet pa vonesë në kohë dhe ti jepet e njëjta rëndësi që i është dhënë informacionit që përmbante faktet që pretendohet se janë të pasakta.

Interpretimi i dispozitave në këtë nen për të drejtën e reagimit do të bëhen në pajtueshmëri me rekomandimet e adoptuara nga Këshilli i Evropës.

Me rastin e vlerësimit të lartësisë së dëmit të shkaktuar, Gjykata do të vendosë nëse ofrimi apo zbatimi nga pala përgjegjëse i të drejtës për reagim, përmirësim, tërheqje apo kërkim falje, ka qenë përmirësim i mjaftueshëm për të përmbushur ankesën apo nëse përmirësimi i tillë mund të konsiderohet rrethanë lehtësuese.

Me nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, përcaktohet se: “ Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së opinionit dhe të shprehjes, gjë që nënkupton të drejtën për të mos u prekur për shkak të opinionëve të tij si dhe të drejtën për të kërkuar, për të marr dhe për të përhapur informata dhe ide me çfarëdo mjeti të mundshëm dhe pavarësisht nga kufijtë ”.

Me nenin 10 paragraf 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, përcaktohet se: “ Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshinë lirinë e mendimit dhe lirinë për të marr ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marr parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv ”.

Si rrjedhojë e gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë dhe kualifikimin e kësaj gjendje faktike në përputhje me të drejtën materiale, kjo gjykatë erdhi në përfundim se e paditura nuk kanë për detyrim që paditësit t’ia kompensoj dëmin mbi bazën e shpifjes, për shkak të informacionit shpifës ndaj personalitetit të paditësit në mënyrë publike, në shumën e gjykuar si në dispozitiv të aktgjyqimit, për arsyeje se në këtë rast rezultoi se e paditura ka dëshmuar para gjykatës se publikimi i fotografisë paditësit në njërin pjesë të emisionit kontestues ka qenë

shqetësues për të, ai është dashur të shfrytëzoj “të drejtën për t’u përgjigjur apo të drejtën për reagim“, sipas nenit 13 të Ligjit Kundër Shpifjes dhe Fyerjes dhe se fotografia e paditësit teksa pin kafe me z. G. Th. e i cili është njëri prej protagonistëve kryesorë të emisionit, sipas palës së paditur është një fotografi e rëndomtë e cila fare nuk ndërlidhet me kontekstin e emisionit, rrjedhimisht paditësi nuk mund të pretendojë se i është shkelur ndonjë e drejtë , ku si rezultat i kësaj shkeljeje ka pësuar dëm material dhe jo-material në vlerën e cekur në padi. I njëjti ka pasur mundësin e parashtrimit të kërkesës për modifikimin e emisionit kontestues pranë organit kompetent rregullativ-Komisionit të Pavarur për Media, në pajtim me përmbajtjen e nenit 12 të LKShF-së dhe që këtë mundësi apo të drejtë nuk e ka shfrytëzuar.

Për efekt të natyrës së kësaj çështje juridike, kjo gjykatë vlerëson se ky aktgjykim është në pajtim me instrumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut e që janë të zbatueshme edhe në Republikën e Kosovës, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës. Kështu, Liria e shprehjes parashihet edhe me nenin 10, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që citon : se gjithkush ka të drejtën e shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë pjesë ose për të dhënë informacion ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë shtetëror. 1. Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund ti nënshtrohen disa formaliteteve , kushteve , kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj , dhe që , në një shoqëri demokratike, përbejnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar , për integritet territorial ose për sigurimin publik , për mbrojtjen e rendit dhe për parandalimin e krimit , për ruajtjen e shëndetit ose moralit , për mbrojtjen të dinjitetit ose të të drejtave të njeriut , për te parandaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë pushteti gjyqësorë. Lidhur me këtë, kjo gjykatë mban në vëmendje edhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim do të përdoret shkurtesa: GJEDNJ), e cila në jurisprudencën e saj në çështjen Handyside kundër Britanisë se Madhe, ka theksuar se liria e shprehjes është një nga shtyllat e shoqërisë demokratike , bazë për zhvillimin e saj dhe kusht për vete realizimin e individit. Ajo nuk mund të përfshijë vetëm informacionet dhe opinionet pozitive , ose të konsiderohen si të dëmshme , apo indiferent por edhe të tilla që fyejnë , trillojnë apo janë shqetësim për shtetin ose për një grup të caktuar të shoqërisë. Të tilla janë kriteret e pluralizmit , të tolerancës dhe të hapjes, pa të cilat një shoqëri demokratike nuk mund të ekzistoj.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në bazë të nenit 452 të LPK.

Përveç të cekurave si në arsyetim të këtij aktgjykimi, kjo gjykatë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera nga padia, përgjigja në padi, seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, andaj nga arsyet e theksuara me larte konform nenit 5 par.4 te Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, lidhur me nenin 143 te Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1330/2016 , më 07.11.2024.

PËRPARIM ZEKA

GJYQTAR

UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtoj ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.